



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:126449

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734133

KPPP.nr.763/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Golden Eagle” SH.P.K., me numër unik identifikues 811484138, me seli në Suharekë, kundër debitorit “Andi Group 2004” SH.P.K., me numër unik identifikues 811291046, me seli në Gjilan, rruga “Abdullah Tahiri” nr.170, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Ex Lege Gashi SH.P.K., me seli në Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.316/24 të datës 27.03.2024, të Përmbaruesit Privat Liridon Tërshani, me seli në Suharekë, jashtë seancës me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET i tërhequr prapësimi i debitorit “Andi Group 2004” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.316/24 të datës 27.03.2024, të Përmbaruesit Privat Liridon Tërshani .

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Golden Eagle” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.316/24 të datës 27.03.2024, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.30-2/29614 të datës 11.01.2023, Faturës Nr.30-2/29834 të datës 16.01.2023, Faturës Nr.30-2/33870 të datës 10.03.2023, Faturës Nr. 30-2/33871 të datës 10.03.2023, Faturës Nr. 30-2/33872 të datës 10.03.2022, Faturës Nr. 30-2/34818 të datës 22.03.2023, Faturës Nr. 30-2/34819 të datës 22.03.2023, Faturës Nr. 30-2/34820 të datës 22.03.2023, Faturës Nr. 30-2/37239 të datës 20.04.2023, Faturës Nr. 30-2/37240 të datës 20.04.2023 dhe Faturës Nr. 30-2/337241 të datës 20.04.2023 me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit në afat prej 7 ditësh t’ia paguaj borxhin e mbetur në shumën prej 2,407.97€ me kamat ligjore 8% ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, deri në pagesën e shumës së kërkuar për përmbarim duke llogaritur edhe kamatën nga dita e pranimit të urdhrin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, po ashtu dhe me regjistrimin,

konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se mes debitorit dhe kreditorit ka pasur marrëveshje reciproke për zbritje bazë prej 5% për çdo faturë dhe pastaj këto zbritje-rabate të zbriten nga çmimi i faturës së furnizimit prej 5%, që nga vlera e obligimit të përfitoj debitori sipas marrëveshjes. Ka shtuar se kreditori ka paraqitur fatura kontestuese në parim të anashkalimit të vlerave reale të mjeteve financiare duke mos paraqitur vetëm fatura të cilat i plotësojnë kriteret, por duke paraqitur edhe bishtim të fakteve duke mos bashkangjitur propozimit edhe fatura të cilat nuk i plotësojnë kriteret ligjore dhe janë të pa bazuara për ekzekutim të këtij urdhëri përmbartimorë, pasi që nuk janë dorëzuar debitorit. Pa ashtu ndër të tjerash ka shtuar se gjykata duhet të përcaktoj se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit për përmbartim pasi që paraqitet diferencë e mbi shtuar e vlerësimit të vlerës montare, disa fatura nuk janë paraqitur asnjë herë për praninë të mallrave, ndërsa Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit si dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguaj debitorit shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën prej 104.00 €.

Me datë 10.05.2024, përfaqësuesi i autorizuar e debitorit me anë të parashtresës, e ka njoftuar gjykatën se për këtë çështje përmbartimore palët kanë arritur marrëveshje për kthimin e borxhit lëndor, andaj me nënshkrimin e kësaj marrëveshje debitori ka njoftuar gjykatën se heq dorë nga prapësimi i datës 16.04.2024.

Andaj gjykata duke vepruar sipas parashtresës së përfaqësueses të autorizuar, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.763/24, datë 24.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.